

**Bekim (Sheremet) Sejdiu**

(1975, shqiptar nga Qirezi/Čirez, komuna e Skënderajt/Srbica)

**Beqir (Brahim) Rexhepi**

(16.03.1968, shqiptar nga Qirezi/Čirez, komuna e Skënderajt/Srbica, automekanik, tre fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Vëllezërit Beqiri, Nazmiu, Bedriu dhe Bekimi jetonin në bashkësi familjare me nënën Abiden në **Qirez/Čirez**. I ati Sheremeti kishte ndërruar jetë përpara luftës. Beqiri ka qenë i martuar me Shukrijen dhe i kishin dy fëmijë. Në mëngjes të datës **28.02.1998**, Beqiri, Bedriu, Nazmiu, Bekimi dhe djali i vogël i Beqirit, Besniku, shkuan për të punuar në fushë. Nga ora 11:30, ata dëgjuan të shtëna që vinin nga drejtimi i Likoshanit/Likošane dhe vendosën të ktheheshin në shtëpi. Në orët në vijim, të gjithë pjesëtarët e familjes Sejdiu i kaluan në drojë nga qitjet e forta nga armë zjarri, si dhe nga helikopterët që fluturonin ultë dhe mbi shtëpinë e tyre. Për një çast, Iliri, komshiu i tyre i parë, erdhi tek ata për të pyetur çfarë po ndodhte. Por, për shkak të breshërive të shumta dhe të forta të të shtënavë, ai nuk ka mundur të kthehej më në shtëpinë e vet. Ai dhe Nazmiu zbritën në bodrumin e shtëpisë së re për tu fshehur nga forcat serbe. Diku nga ora 15:30, në oborrin e familjes Sejdiu hyri tanku i parë me një grup policësh serb që shtënin mbi shtëpinë. E kanë rrënuan derën e shtëpisë dhe kanë hyrë në dhomë ku ishin Beqiri, Bedriu dhe Bekimi. Beqiri e mbante Besnikun në prehër. Policët i shanin dhe i shqelmonin anëtarët e familjes Sejdiu. Më pas, i nxorën me dhunë jashtë në oborr dhe u urdhëruan që të shtriheshin në tokë. Filluan t'i rrihnin burrat duke i akuzuar se ishin terroristë. Për një çast, dikush shtëni mbi policët nga drejtimi i hambarit dhe Beqiri, Bekimi dhe Bedriu deshën të shfrytëzonin hutinë e krijuar. Tentuan të arratiseshin me vrap. Në të njëjtin çast, Nazmiu tentoi që të kalonte me vrap nga shtëpia e re në atë të vjetrën. Por, pjesëtarët e forcave serbe shtënën ndaj të gjithëve. Së pari e kanë qëlluar Nazmiun në shpinë, e më pas Bekimin, i cili tentonte të kalonte pranë tankut. Beqiri dhe Bedriu u qëlluan

në distancë prej afro 30 metra larg shtëpisë së re. Pas pak, policët e nxorën Ilirin jashtë bodrumit dhe e çuan në drejtim të panjohur. Vetëm në mbrëmje, nga ora 20:00, kur pjesëtarët e forcave serbe u tërhoqën nga oborri, fqinjët i kanë futur trupat e Bekimit dhe të Nazmiut brenda në shtëpi. Ditën tjetër, rreth orës 15:00, nëna Abide dhe disa fqinjë të saj i gjetën trupat e Beqirit dhe Bedriut. Pranë hambarit, po ashtu, e kanë gjetur trupin e Beqir Rexhepit, për të cilin nuk dihej se si kishte arritur aty. Familjarët e Ilirit e kanë marrë trupin e tij nga morgu i spitalit të Prishtinës/Priština më 3.03.1998. Po atë ditë, Iliri, Beqiri, Bedriu, Nazmiu dhe Bekimi u varrosën në varrezat e Likoshanit/Likošane, së bashku me që të gjithë ata që u vranë apo kanë rënë më 28.02.1998.

**Burimet:** deklarata A.S, FDH-15198; deklarata A.S, FDH-12038; deklarata H.N, FDH-15199; deklarata Z.R, FDH-1540; deklarata B.R, FDH-12049; deklarata Z.R, FDH-12043; deklarata Z.R, FDH-12035; deklarata Z.R, FDH-15401; SHFĐUÇK, *Fenikset...*3,87-89; J.Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092.

**Muhamet (Isuf) Gjeli**

(18.01.1928, shqiptar nga Likoshani/Likošane, komuna e Glogocit/Glogovac, pensionist, dhjetë fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

**Naser (Muhamet) Gjeli**

(24.02.1959, shqiptar nga Likoshani/Likošane, komuna e Glogocit/Glogovac, tre fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Përpara se të shkonte në pension, Muhameti punonte si ngasës ekskavatori. Jetonte me djalin Naserin, ndërsa në shtëpinë përball tyre jetonte djali tjetër Kadriu me familje. Muhameti dhe Naseri u bënë anëtarë të UÇK-së, kur kjo i themeloi celulat e veta të para në fshatrat e Glogocit/Glogovac dhe Skënderajt/Srbica. Në datën **28.02.1998**, Kadriu shkoi herët në punë në fabrikën e *Ferronikelit*. Rreth orës 11:30, kur [nga drejtimi Qirezit/Čirez dhe **Likoshanit/Likošane**] filluan të dëgjoreshin breshëritë e shtënavë të fuqishme, djemtë e Kadriut, Bekimi dhe Fatmiri, së bashku me djelmoshat e *Mëhallës Imeri*, i braktisën shtëpitë e veta dhe u fshehën në pyll. Djali i tretë i Kadriut, Iliri u fsheh në tav-